2. Pasuritë e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi i shtohen listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës", të ndryshuar.

3. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**


PLANVENDOSJE
BASHKIA TIRANË
Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf
RAIF HALIDINI
DREJTORIA VENDORE E ASHK-së, TIRANË JUG.
A. IDENTIFIKIMI I PASURISË
ZONA KADASTRALE: 8270
NR. I PASURISË: 8/72
VOL. 21 FQ. 245
INDEKS HARTE: TR-U,V-10
SHKALLA: 1:1000
ADRESA E PASURISË: Rrethi: Tiranë
Q/F: Tiranë Rr/L: "Anton Ashta"
P/G: Shk: K: Ap:
B. KUFIZIMET
VERI: 8/545
JUG: 8/412
LINDJE: 8/103
PERENDIM: 8/9
C: PRONARI
SHTET
D: Data: Ora:
KRGJSH
KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKB NR. 10, DATË 31.10.2018, PËR TRANSFERIM NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.
SIP. TR. = 33778.20 M²; SIP. ND.= 2064.10 M²
LEGJENDË
1 X: 484184.10 Y: 4575427.88
2 X: 484304.81 Y: 4575343.20
3 X: 484275.41 Y: 4575303.44
4 X: 484316.85 Y: 4575269.56
5 X: 484320.49 Y: 4575240.44
6 X: 484233.85 Y: 4575179.90
7 X: 484093.50 Y: 4575275.25
8/72
8/9
8/656
8/417
8/590
8/391
8/134
8/545
8/133
8/638
8/637
8/412
8/165
8/552
8/150
8/132
8/103
8/104
8/151
8/289
8/315

## PLANVENDOSJE

BASHKIA TIRANË

Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf
RAIF HALIDINI

DREJTORIA VENDORE E ASHK-së, TIRANË VERI

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE: 8210
NR. I PASURISË: 3/221 VOL. 29 FQ. 186
INDEKS HARTE: TR-O-8
SHKALLA: 1:500
ADRESA E PASURISË: Rrethi: Tiranë
Q/F: Tiranë Rr/L: "Muhamet Gjollesha"
P/G: ________ Shk: ________ K: ________ Ap: ________

B. KUFIZIMET
VERI: 3/122
JUG: 3/72
LINDJE: 3/68
PERENDIM: 3/217

C: PRONARI
SHTET

D: Data: ______________ Ora: ______________

## KRGJSH

KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKB NR. 10, DATË 31.10.2018, PËR TRANSFERIM NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.
SIP. ND = 646.60 M²




### LEGJENDA

| | | |
|---|---|---|
| 1 | X=483479.64 | Y= 4577218.50 |
| 2 | X=483488.04 | Y= 4577215.00 |
| 3 | X=483461.02 | Y= 4577157.18 |
| 4 | X=483452.90 | Y= 4577160.68 |
| 5 | X=483464.94 | Y= 4577187.28 |
| 6 | X=483461.58 | Y= 4577188.96 |
| 7 | X=483464.24 | Y= 4577195.12 |
| 8 | X=483468.30 | Y= 4577193.16 |

## PLANVENDOSJE

BASHKIA TIRANË

Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf
RAIF HALIDINI

DREJTORIA VENDORE E ASHK-së, TIRANË VERI

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE: 8210
NR. I PASURISË: 3/219 VOL. 29 FQ. 184
INDEKS HARTE: TR-O-8
SHKALLA: 1:500
ADRESA E PASURISË: Rrethi: Tiranë
Q/F: Tiranë Rr/L: "Muhamet Gjollesha"
P/G: ________ Shk: ________ K: ________ Ap: ________

B. KUFIZIMET
VERI: 3/218
JUG: 3/72
LINDJE: 3/68
PERENDIM: 3/74

C: PRONARI
SHTET

D: Data: ______________ Ora: ______________

## KRGJSH

KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKB NR. 10, DATË 31.10.2018, PËR TRANSFERIM NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.
SIP. TR = 420 M²

| LEGJENDA | | |
|---|---|---|
| 1 | X=483470.05 | Y= 4577176.61 |
| 2 | X=483461.02 | Y= 4577157.18 |
| 3 | X=483452.90 | Y= 4577160.68 |
| 4 | X=483451.71 | Y= 4577164.15 |
| 5 | X=483434.91 | Y= 4577161.77 |
| 6 | X=483427.07 | Y= 4577161.77 |
| 7 | X=483427.35 | Y= 4577164.99 |
| 8 | X=483425.53 | Y= 4577166.81 |



# PLANVENDOSJE

BASHKIA: TIRANË

Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf
RAIF HALIDINI

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE: 8270
NR. I PASURISË: 8/700 VOL. 81 FQ. 158
INDEKS HARTE: TR-U-9
SHKALLA: 1:500
ADRESA E PASURISË: Rrethi: Tiranë
Q/F: Tiranë Rr/L: "Muharrem Butka"
P/G: __________ Shk: __________ K: __________ Ap: __________

B. KUFIZIMET
VERI: 8/510
JUG: 8/909-993
LINDJE: 8/992-991-989
PERENDIM: 8/699

C: PRONARI
SHTET

D: Data: ________________ Ora: ________________

KRGJSH

KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKB NR. , DATË 2020, PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.
SIP. = 139 M²




LEGJENDË

| | | |
|---|---|---|
| 1 | X: | 483880.46 |
| | Y: | 4575312.19 |
| 2 | X: | 483884.38 |
| | Y: | 4575310.79 |
| 3 | X: | 483880.60 |
| | Y: | 4575279.85 |
| 4 | X: | 483873.74 |
| | Y: | 4575283.91 |
| 5 | X: | 483881.86 |
| | Y: | 4575306.87 |
| 6 | X: | 483879.76 |
| | Y: | 4575307.99 |

# PLANVENDOSJE

| BASHKIA: TIRANË<br><br>Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf<br>RAIF HALIDINI | A. IDENTIFIKIMI I PASURISË<br><br>ZONA KADASTRALE: 8270<br>NR. I PASURISË: 8/582 VOL. 25 FQ. 18<br>INDEKS HARTE: TR-U-9<br>SHKALLA: 1:500<br>ADRESA E PASURISË: Rrethi: Tiranë<br>Q/F: Tiranë Rr/L: "Muharrem Butka"<br>P/G: ________ Shk: ________ K: ________ Ap: ________<br><br>B. KUFIZIMET C: PRONARI SHTET<br>VERI: 8/660<br>JUG: 8/909<br>LINDJE: 8/699<br>PERENDIM: 8/660<br><br>D: Data: ______________ Ora: ______________ |
|---|---|

KRGJSH

KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKB NR. , DATË 2020, PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.
SIP. = 188 M²




| LEGJENDË | | |
|---|---|---|
| 1 | X: | 483862.12 |
| | Y: | 4575308.41 |
| 2 | X: | 483854.42 |
| | Y: | 4575292.73 |
| 3 | X: | 483847.98 |
| | Y: | 4575292.31 |
| 4 | X: | 483847.98 |
| | Y: | 4575311.35 |
| 5 | X: | 483849.80 |
| | Y: | 4575313.03 |

## PLANVENDOSJE

BASHKIA: TIRANË

Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf
RAIF HALIDINI

DREJTORIA VENDORE E ASHK-sw, TIRANA JUG.

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE: 8150
NR. I PASURISË: 2/21 VOL. 26 FQ. 248
INDEKS HARTE: TR-O-12
SHKALLA: 1:500
ADRESA E PASURISË: Rrethi: Tiranë
Q/F: Tiranë Rr/L: "Kostandin Kristoforidhi"
P/G: ________ Shk: ________ K: ________ Ap: ________

B. KUFIZIMET
VERI: 2/291
JUG: 2/32
LINDJE: 2/32
PERENDIM: 2/291

C: PRONARI
SHTET

D: Data: ____________ Ora: ____________

### KRGJSH

KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKB NR. 10, DATË 31.01.2018, PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.
SIP. TR/ND = 132 M²




| LEGJENDA | | |
|---|---|---|
| 1 | X= 485149.92 | Y=4577183.98 |
| 2 | X= 485154.68 | Y=4577185.82 |
| 3 | X= 485164.73 | Y=4577162.37 |
| 4 | X= 485159.99 | Y=4577160.30 |

## 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia Tirane

| | | | |
|---|---|---|---|
| Identifikoi: | Albana Hoxha | Pergj/Sektori | Raif Halidini | Specialist |
| | Ervin Nikolla | Drejtor I Deleguar | |
| Supervizoi: | Alban Dokushi | Drejtor | |
| Aprovoi: | Erjon Veliaj | Kryetar | |

Fusha e perdorimit te Prones: Sport.

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones m2 | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 10 | 8270<br>U,V-9,10<br>v 21,fq,245 | 8/72 | Truall<br>Ndertese | Kompleksi I Pishinave<br>Liqeni Artificial<br>Bashkia Tirane | 33778.2 | 2064.1 | Sport | Bashkia Tirane | Bashkia Tirane | |
| | 8210<br>O- 8<br>v 29,fq,186 | 3/221 | Ndertese | St.i lojrave me dore<br>Rr. M Gjollesha | | 646.6 | Sport | Bashkia Tirane | Bashkia Tirane | |
| | 8210<br>O- 8<br>v 29,fq,184 | 3/219 | Truall | St.i lojrave me dore<br>Rr. M Gjollesha | | 420 | Sport | Bashkia Tirane | Bashkia Tirane | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia : Tiranë

Fusha e perdorimit te Prones Arsimore

Identifikoi: Albana Hoxha (përgjegjës sektori) ;Raif Halidini (Specialist)

Supervizoi: Alban Dokushi,Drejtor (Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit)

Aprovoi: Erlon Vellaj (Kryetar)

| Nr. Rend. | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 8270 TR- U-9 | 8/700 | Truall | Rr. Muharrem Butka | 139 | | Arsim | Bashkia Tirane | Bashkia Tirane | shtret- v.81, fq 158 v.25, fq 17 |
| 2 | 8270 TR- U-9 | 8/582 | Truall | Rr. Komuna Parisit | 188 | | Arsim | Bashkia Tirane | Bashkia Tirane | Shtet, v.25, fq 18 |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia Tirane

Identifikoi: Albana Hoxha Pergj/Sektori / Raif Halidini Specialist
Ervin Nikolla Drejtor I Deleguar
Supervizoi: Alban Dokushi Drejtor

Fusha e perdorimit te Prones: Zhvillim ekonomik, Sherbime, Prodhim ,Sport.

Aprovoi: Erjon Veliaj Kryetar

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones m2 | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 29 | 8150<br>O- 12<br>v 26,fq248 | 2/21 | Truall<br>Ndertese | DPNR.1 PQ<br>Godina e Punetoreve<br>Bashkia Tirane | 132 | 132 | Sherbim | Bashkia Tirane | Bashkia Tirane | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

**VENDIM**
**Nr. 957, datë 2.12.2020**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË "SHIJAKU" SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË SHTETËRORE ME NUMRA PASURIE 287/1, 283/24, 283/20, 283/22, ZK 2954, DHE 133/326, 133/328, ZK 3266, ME VENDNDODHJE NË SAUK, TIRANË, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 136 716 m$^2$, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE MINISTRISË SË KULTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si Qiradhënës, dhe shoqërisë "Shijaku" sh.p.k., si qiramarrës, për pasuritë shtetërore, me vendndodhje në fshatin Sauk, Tiranë, në ZK 3266 dhe në ZK 2954, prona nr. 184, me numër pasurie 287/1, me sipërfaqe totale 27 000 m$^2$, sipërfaqe ndërtimorë 864.1 m$^2$, me emërtimin "Vendkomanda Qendrore", prona nr. 186, me numër pasurie 283/24 dhe 133/328, me sipërfaqe totale 49 900.85 m$^2$, sipërfaqe ndërtimore 545 m$^2$, me emërtimin "Ish-reparti ushtarak nr. 3042, Qendër Stërvitore", prona nr. 188, me numër pasurie 283/20, me sipërfaqe 25 881 m$^2$, sipërfaqe ndërtimore 303 m$^2$, me emërtimin "Bateri PZ" dhe prona nr. 1300, me numër pasurie 283/22, 133/326, me sipërfaqe 33 934.15 m$^2$, sipërfaqe ndërtimore 226 m$^2$, me emërtimin "Ish-reparti ushtarak nr. 3042, Qendër Stërvitore", me sipërfaqe të përgjithshme 136 716 m$^2$ truall, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Kulturës, për një periudhë 20 (njëzet) vjet, sipas genplanit dhe projektkontratës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**ZYRA E NOTERISË TIRANË**
**Nr. ______ rep.**
**Nr. ______ kol.**

**DRAFT**
**KONTRATË QIRAJE**
**Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata**

**Lidhur**

në Tiranë, sot, më datë ________, të muajit _________, të vitit 2020 (dy mijë e njëzet), u paraqitën para meje noterit___________________, palët kontraktuese, si më poshtë vijon:

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.____prot., datë___.___.2020, nga_________________ i datëlindjes______, banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare, i pajisur me kartën e identitetit me nr. personal _____________, që më poshtë do të quhet:

"**Qiradhënësi**"

**dhe**

**shoqëria "Shijaku" sh.p.k.,** me seli qendrore në Arrameras, Fushë-Krujë dhe me numër identifikimi (NUIS) J64102272V, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja me NIPT, përfaqësuar nga administratori ___________,

identifikuar me letërnjoftimin personal me nr. _________, që më poshtë do të quhet:

"**Qiramarrësi**".

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me propozimin nr. 4977/4 prot., datë 19.11.2020, të Ministrisë së Mbrojtjes dhe nr. 4596/1 prot., datë 11.11.2020, të Ministrisë së Kulturës, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", të ndryshuar, sipas kërkesës së shoqërisë "Shijaku" sh.p.k., datë 15.10.2020, me objekt "Për marrjen me qira me tarifën simbolike 1 euro/kontrata me "ofertë të pakërkuar", të pronës shtetërore me vendndodhje në fshatin Sauk, Tiranë, ZK nr. 3266 dhe ZK nr. 2954, prona nr. 184, me numër pasurie 287/1, me sipërfaqe totale 27 000 $m^2$, sipërfaqe ndërtimorë 864.1 $m^2$ me emërtimin "Vendkomanda Qendrore", prona nr. 186, me numër pasurie 283/24 dhe 133/328, me sipërfaqe totale 49 900.85 $m^2$, sipërfaqe ndërtimore 545 $m^2$, me emërtimin "Ish- reparti ushtarak nr. 3042, Qendër Stërvitore", prona nr. 188, me numër pasurie 283/20, me sipërfaqe 25 881 $m^2$, sipërfaqe ndërtimore 303 $m^2$, me emërtimin "Bateri PZ" dhe prona nr. 1300, me numër pasurie 283/22, 133/326, me sipërfaqe 33 934.15 $m^2$, sipërfaqe ndërtimore 226 $m^2$ me emërtimin "Ish-reparti ushtarak nr. 3042, Qendër Stërvitore", me sipërfaqe të përgjithshme 136 716 $m^2$ truall, në përgjegjësi administrimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Kulturës, bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, së bashku me Qiramarrësin, palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë.

Neni 1

**Objekti i kontratës**

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë shtetërore me vendndodhje në fshatin Sauk, Tiranë, ZK nr. 3266 dhe ZK nr. 2954, prona nr. 184, me numër pasurie 287/1, me sipërfaqe totale 27 000 $m^2$, sipërfaqe ndërtimorë 864.1 $m^2$, me emërtimin "Vendkomanda Qendrore", prona nr. 186, me numër pasurie 283/24 dhe 133/328, me sipërfaqe totale 49 900.85 $m^2$, sipërfaqe ndërtimore 545 $m^2$, me emërtimin "Ish-reparti ushtarak nr. 3042, Qendër Stërvitore", prona nr. 188, me numër pasurie 283/20, me sipërfaqe 25 881 $m^2$, sipërfaqe ndërtimore 303 $m^2$, me emërtimin "Bateri PZ" dhe prona nr. 1300 me numër pasurie 283/22, 133/326, me sipërfaqe 33 934.15 $m^2$, sipërfaqe ndërtimore 226 $m^2$ me emërtimin "Ish-reparti ushtarak nr. 3042, Qendër Stërvitore", me sipërfaqe të përgjithshme 136 716 $m^2$ truall, në përgjegjësi administrimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Kulturës, për një periudhë 20 (njëzet) vjet, sipas genplanit dhe kontratës bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 2

**Qëllimi i përdorimit**

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia me qira në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, me qëllim ngritjen e qendrave të organizuara sociale dhe shërbimeve jopublike në fushën e shërbimeve sociale, që ndikojnë për zgjidhjen e problemeve sociale dhe për ushtrim të veprimtarive në fushën e sportit, të kulturës, në fushën e turizmit dhe të trashëgimisë kulturore. Investimi do të konsistojë në ndërtimin dhe operimin e Infrastrukturës sociale, duke investuar **1,576,239,000 lekë pa TVSH** dhe duke punësuar minimalisht **80 punonjës**.

Neni 3

**Kohëzgjatja**

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzet) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4

**Të drejtat dhe detyrimet e Qiradhënësit**

4.1 Qiradhënësi, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Kulturës, si njësi që kanë në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit, që jepet me qira, i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 Qiradhënësi ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësive monitoruese të kontratës së qirasë, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.3 Qiradhënësi është i detyruar të garantojë Qiramarrësin për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë. MFE-ja, në cilësinë e Qiradhënësit nuk mban asnjë përgjegjësi ligjore për problematikat që mund t'i lindin Qiramarrësit gjatë ezaurimit të kontratës, me pronat private kufitare me pasuritë objekt kontrate. Çdo lloj pretendimi nga të tretë, do të zgjidhet nga vetë Qiramarrësi, duke përjashtuar MFE-në si Qiradhënës, nga çdo lloj detyrimi apo pasojë të mundshme.

4.4 Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.5 Qiradhënësi nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5

**Të drejtat dhe detyrimet e Qiramarrësit**

5.1 Qiramarrësi ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 Qiramarrësi ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

5.3 Qiramarrësi detyrohet që në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin, sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në planin biznesin e paraqitur për shqyrtim.

5.4 Qiramarrësi detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 Qiramarrësi detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 Qiramarrësi detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 Qiramarrësi, në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate do të investojë për të ngritur aty kompleks multifunksional në fushën e shërbimeve social-kulturore, përfshirë dhe njësi akomoduese, me qëllim rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së strukturave dhe shërbimeve jopublike në fushën e shërbimeve sociale.

5.8 Qiramarrësi, në funksion të zhvillimit të aktivitetit dhe sipas kushteve të propozuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe të marra përsipër nga Qiramarrësi, duhet të mos e ndryshojë destinacionin e pronës për të cilën do të jepet me qira, konstruksionin e tuneleve të ish-Vendkomandës Qendrore dhe, në rast nevoje, të Forcave të Armatosura, rikthimin e pronave Ministrisë Mbrojtjes (KFA-së).

**Totali i vlerës së investimeve në pasurinë shtetërore, sipas plan-biznesit është 1,576,239,000 lekë pa TVSH dhe do të përfundojë brenda 48 muajve, nga data e nxjerrjes të lejeve përkatëse për punimet.**

Sipas plan-biznesit të paraqitur, ky investim do të realizohet në tre faza si vijon:

1. Faza e parë përfshin dy vite dhe parashikon të përfundohen të gjitha projektet, si edhe punimet paraprake për rregullime të terrenit dhe ngritjes së kantierit dhe parashikohet mbërritja në kuotën 0 në shumicën e godinave, si dhe përparim më i mirë me njësitë.
2. Faza e dytë është parashikuar përfundimi i karabinasë për të gjitha ndërtimet.
3. Faza e tretë do të punohet me fasada, rifinitura dhe interiore, në mënyrë që kompleksi të jetë operativ dhe gati për të realizuar qëllimin e projektimit të tij.

5.9 Qiramarrësi, sipas parashikimit për punësimin të shprehur në plan-biznesin e paraqitur investimi do të përfundojë 48 muaj nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse dhe në fazën e parë do të punësojë 35 punonjës me kohë të plotë. Gjate fazës së dytë do të punësojë minimalisht 50 punonjës dhe në përfundim të fazës së tretë ky numër do të jetë 80+1 punonjës. Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuara, transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

Qiramarrësi detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

5.10 Qiramarrësi, në funksion të qëllimit, sipas nenit 2, dhe të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.8, 5.9, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe autorizime të posaçme nga organet kompetente.

5.11 Qiramarrësi detyrohet të paraqesë te Qiradhënësi, në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.12 Qiramarrësi detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.13 Qiramarrësi, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme, të kryera nga Qiramarrësi.

5.14 Në ngarkim të Qiramarrësit janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.15 Qiramarrësit nuk i lejohet që pronën e dhënë me qira, ta japë me nën qira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

5.16 Qiramarrësi, në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt të kësaj kontrate.

Neni 6

**Pagesa e qirasë**

6.1 Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë Qiradhënësit detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro.

Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata, sipas faturës të lëshuar nga Qiradhënësi.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës, Qiramarrësi detyrohet të paguajë garancinë e kontratës, në vlerën 2% të vlerës së investimit të marrë përsipër, sipas plan-biznesit, në një nga format e garancisë bankare/kompani sigurimi, e cila qëndron e ngurtësuar për llogari të qiradhënësit deri në përfundim të investimit.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, Qiramarrësi do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e Qiradhënësit, sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7

**Penalitetet**

7.1 Në rastin kur Qiramarrësi, sipas përcaktimeve në pikat 5.8, 5.9, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, Qiradhënësi zgjidh kontratën dhe sanksionon Qiramarrësin, me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, Qiramarrësi nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, 5.9, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8

**Zgjidhja e kontratës**

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve;

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;

c) kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 5 dhe 6 të kësaj kontrate;

d) kur Qiramarrësi ndryshon destinacionin për të cilin është lidhur kontrata;

e) kur prona nevojitet për interes publik;

f) kur prona kalon në procedurë privatizimi.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 30 ditë pas njoftimit me shkrim të Qiradhënësit për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj, dhe nëse Qiramarrësi nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9
**Përgjegjësitë e palëve**

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga Qiramarrësi, sipas pikave 5.8, dhe 5.9 dhe 5.10 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët janë të detyruara që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta, për realizimin e kushteve të kontratës në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmbytjet, lufta, dhe çdo pengesë tjetër e konstauar si gjendje me akt ligjor. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 Qiramarrësi përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe moskryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10
**Dispozitat e fundit**

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'i referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë plan-biznesi i miratuar, procesverbali i marrjes në dorëzim të objektit, sipas kontratës së qirasë dhe gentplani i pronës.

10.3 Mosmarrëveshjet, që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor që ka juridiskionin territorial dhe lëndor.

10.4 Në rast të mosmarrëveshjeve të lindura mes palëve, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin që prona publike e dhënë me qira, privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

11.1 Brenda 1 (një) muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

11.2 Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen Qiramarrësit.

11.3 Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter ________________, në bazë të nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

| **QIRADHËNËSI** | **QIRAMARRËSI** |
|---|---|
| **Ministria e Financave dhe Ekonomisë** | **Shoqëria "Shijaku" sh.p.k.** |
| **Përfaqësuar nga** | **Përfaqësuar nga** |

Kontratë qiraje me çmimin simbolik 1 euro/kontrata, lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe shoqërisë "Shijaku"sh.p.k si qiramarrës, për pronën shtetërore me vendndodhje në fshatin Sauk, Tiranë, prona nr.184 me numër pasurie 287/1, me sipërfaqe totale 27 000 m2, sipërfaqe ndërtimorë 864.1m2 me emërtimin "Vendkomanda Qendrore", prona nr.186, me numër pasurie 283/24 dhe 133/328 me sipërfaqe totale 49 900.85 m2, sipërfaqe ndërtimore 545m2, me emërtimin "Ish reparti ushtarak nr.3042, Qendër Stërvitore", prona nr.188 me numër pasurie 283/20, me sipërfaqe 25 881 m2, sipërfaqe ndërtimore 303 m2, me emërtimin "Bateri PZ" dhe prona nr.1300 me numër pasurie 283/22, 133/326, me sipërfaqe 33 934.15 m2, sipërfaqe ndërtimore 226 m2 me emërtimin "Ish reparti ushtarak nr.3042, Qendër Stërvitore", me sipërfaqe të përgjithshme 136 716 m2 truall, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Kulturës, sipas genplanit bashkëlidhur.




| NR | NR PRONE | ZONE KADAST RALE | NR PASURIE | VOLUM | FAQE | SIP TOTALE TRUALL | SIP NDERTIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 184 | 2954 | **287 / 1** | 4 | 50 | 27000 | 864.1 |
| 2 | 186 | 2954 | **283 / 24** | 5 | 94 | 43200.85 | 0 |
| 3 | 186 | 3266 | **133 / 328** | 35 | 174 | 6700 | 545 |
| 4 | 188 | 2954 | **283 / 20** | 5 | 90 | 25881 | 303 |
| 5 | 1300 | 2954 | **283 / 22** | 5 | 92 | 18734.15 | 226 |
| 6 | 1300 | 3266 | **133 / 326** | 35 | 172 | 15200 | 0 |
| | | | | | **TOTAL** | **136716** | **1938.1** |

**VENDIM**
**Nr. 958, datë 2.12.2020**

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE E TË KUSHTEVE TË CERTIFIKIMIT TË PERFORMANCËS SË ENERGJISË SË NDËRTESAVE DHE TË MODELIT, PËRMBAJTJES E KUSHTEVE TË REGJISTRIMIT TË "CERTIFIKATËS SË PERFORMANCËS SË ENERGJISË SË NDËRTESAVE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 10, të ligjit nr. 116/2016, "Për performancën e energjisë së ndërtesave", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim e shtrin fushën e zbatimit vetëm në ndërtesat dhe në njësitë e ndërtesave të referuara në pikën 1, të nenit 10, të ligjit nr. 116/2016, "Për performancën e energjisë së ndërtesave", sipas kategorive të përcaktuara me ligj.

2. Termat e përcaktuar në ligjin nr. 116/2016, "Për performancën e energjisë në ndërtesa", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Blloku i apartamenteve", ndërtesë banimi me një numër të madh apartamentesh;

b) "Certifikata e përkohshme e performancës së energjisë (CPPE)", dokument i lëshuar nga auditUesi i energjisë në ndërtesa, ku përcaktohet performanca e energjisë së një ndërtese ose të njësisë së një ndërtese në fazë projektimi;

c) "Raport i auditimit", dokumenti që shoqëron Certifikatën e Performancës së Energjisë (në vijim CPE) sipas formatit të përcaktuar në rregulloren e hartuar nga agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë dhe të miratuar nga ministri;

ç) "Raport i verifikimit", dokumenti që shoqëron CPE-në sipas formatit të përcaktuar në rregulloren e hartuar nga agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë dhe të miratuar nga ministri;

d) "Regjistri Kombëtar i Certifikatave për Performancën e Energjisë", një bazë të dhënash, e cila krijohet e administrohet nga agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë, e cila, për qëllime të këtij vendimi:

i. regjistron e ruan në bazën e të dhënave certifikatat për performancën e energjisë së ndërtesave dhe të njësive të ndërtesave;

ii. regjistron dhe ruan në bazën e të dhënave raportin e auditimit dhe raportin e verifikimit, si edhe informacione të tjera të lidhura me certifikatat e performancës së energjisë;

iii. lejon, përmes zyrtarit të autorizuar, procesin e mbikëqyrjes së CPE-ve nga agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë;

iv. siguron, përmes zyrtarit të autorizuar, lejimin e palëve të interesuara për të kontrolluar vlefshmërinë e certifikatave të performancës së energjisë dhe të raporteve të auditimit e të verifikimit që shoqërojnë certifikatën.

dh) "Zona e përbashkët", zonë e një ndërtese, e cila përdoret nga dy ose më shumë njësi ndërtimi, për qëllime të përdorimit të përbashkët ose si një rrugë e tërthortë.

## KREU II
## KUSHTET DHE PROCEDURA PËR CERTIFIKIMIN E PERFORMANCËS SË ENERGJISË SË NDËRTESAVE

**I. Kushtet e certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave**

1. Kushtet e certifikimit të performancës së energjisë, për ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese, në të gjithë territorin e Republikën e Shqipërisë, përfshijnë:

a) zbatimin e programit kompjuterik të miratuar që gjeneron CPE-në e ndërtesës nga auditues energjetik të certifikuar, në përputhje me Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes së miratuar, si mjeti unik që përcakton algoritmet e të gjitha detajet teknike për vlerësimin numerik të performancës së energjisë;

b) zbatimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesat e përcaktuara në vendimin nr. 537, datë 8.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave";

c) verifikimin nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë të të dhënave të dorëzuara nga audituesit energjetik, në përputhje me parashikimet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 13, të ligjit nr. 116/2016, "Për performancën e energjisë së ndërtesave".

**II. Procedurat e certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave**

1. Çdo subjekt që ka në pronësi ose administrim një ndërtesë, për të cilën është i detyrueshëm certifikimi i performancës së energjisë, zgjedh një auditues energjie nga Regjistri i Audituesve Energjetik të certifikuar, të publikuar në faqen zyrtare të agjencisë përgjegjëse për eficiencën e energjisë.

2. Audituesi i energjisë kryen auditimin energjetik, duke ndjekur rregullat e përcaktuara në Kodin e Praktikës dhe lëshon CPE-në dhe raportin e verifikimit mbi bazën e të dhënave hyrëse. Për mbledhjen e të dhënave hyrëse për gjenerimin elektronik të një CPE-je, audituesi energjetik i certifikuar ndërmerr një studim në terren dhe përpunon të dhëna që çojnë në krijimin e:

a) dosjes së të dhënave dhe/ose të formularit të të dhënave hyrëse për programin kompjuterik të miratuar mbi bazën e të cilave audituesi energjetik kryen llogaritjet e gjeneron CPE-në;

b) shënimeve të terrenit - komentet mbi të dhënat e projektit, duke përfshirë vlerësimin profesional të shoqëruar me pamje fotografike nga objekti;

c) planimetrive, të prerjeve etj., të cilat lejojnë llogaritjen e performancës së energjisë. Kjo dosje duhet të përbëhet nga planimetri që mbulojnë të gjitha katet, zonimin dhe informacione të tjera që identifikojnë objektin e auditimit;

ç) pamjeve ajrore të ndërtesës nga imazhet satelitore apo pamje të ngjashme që identifikojnë qartë ndërtesën dhe paraqitjen e terrenit për të konfirmuar orientimin e vendndodhjen;

d) zonimit të hapësirave të brendshme sipas funksionit, sipas një kodi shenjash;

dh) të gjitha pamjeve të jashtme: para, prapa dhe anësore;

e) vizatimeve për prerjet e elementeve të ndërtesës – p.sh. mur i izoluar ose jo, ku duhet të përcaktohen të gjitha llojet e materialeve të shtresave që përbëjnë murin e karakteristikat termike të tyre;

ë) llojeve të xhamave, duke përfshirë vlerën G, sipas kritereve të dhëna në standardin EN ISO 410 dhe/ose të të njëjtit standard shqiptar në fuqi SSH EN 410 - Qelqi në ndërtim - Përcaktimi i karakteristikave ndriçuese dhe diellore të paneleve;

f) hijezuesit dhe karakteristikat termike të tyre;

g) konstruksionit të çatisë dhe të ndriçimit të çatisë;

gj) për çdo sistem ngrohjeje, ftohjeje, ventilimi dhe kondicionimi në varësi nga lloji i sistemit: vlerat e treguesit të eficiencës së energjisë (EER), llojin e çillerit/ftohësit e të gjeneratorit të nxehtësisë, sistemin e rikuperimit të nxehtësisë, praninë e ventilatorëve dhe pompave së bashku me fuqinë e pompës e/ose fuqinë specifike të ventilatorit, llojin e lëndës djegëse dhe kontrollet (duke përfshirë prodhuesin e pajisjeve teknike/modelin e numrin serial, e çdo dëshmi vlerësimi nga palët e treta);

h) emetuesit terminal të nxehtësisë për ngrohje/ftohjen brenda zonës/zonave;

i) sistemeve të kontrollit brenda dhomës/zonave (tërësi hapësirash);

j) llojit të sistemit të furnizimit me ujë të ngrohtë, eficienca, lënda djegëse, vëllimi dhe/ose humbjet e nxehtësisë në rezervuar, fuqia e pompës, riqarkullimi i ujit të ngrohtë;

k) llojit të sistemit/sistemeve të ndriçimit brenda zonave.

3. Në përfundim të auditimit energjetik dhe gjenerimit të CPE-së, duke përdorur programin kompjuterik të miratuar, audituesi i energjisë dërgon në formë elektronike, në sistemin kompjuterik, kërkesën për regjistrimin e "Certifikatës së performancës së energjisë" në Regjistrin Kombëtar të Certifikatave për Performancën e Energjisë.

## KREU III
## MODELI, PËRMBAJTJA DHE KUSHTET E REGJISTRIMIT TË CERTIFIKATËS SË PERFORMANCËS SË ENERGJISË

1. Modeli, përmasat dhe përmbajtja e certifikatës janë sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Procedurat për regjistrimin e "Certifikatës së performancës së energjisë së ndërtesave" administrohen nga agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë dhe përfshijnë:

a) kontrollin në Regjistrin e Audituesve Energjetik të Certifikuar, nëse audituesi i energjisë është i certifikuar;

b) kontrollin e të dhënave, si: identifikimi i vlerësuesit, identiteti i pronarit të ndërtesës, detajet e ndërtimit dhe të dhëna të tjera, për plotësimin e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Certifikatave për Performancën e Energjisë;

c) kontrollin, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, të vlerave hyrëse në programin kompjuterik të miratuar, të cilat janë përpiluar më parë nga agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë, në përputhje me metodologjinë kombëtare të llogaritjes, të miratuar për vlerat hyrëse në programin kompjuterik të miratuar. Në qoftë se këto vlera nuk janë plotësuar sipas formatit, agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë kërkon me postë elektronike nga audituesi energjetik rishikimin e tyre, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi. Aplikimi rifutet në procedurë pas plotësimit të këtyre vlerave;

ç) regjistrimin e Certifikatës së Performancës së Energjisë, si dhe lëshimin e një numri unik identifikimi ose kodi të certifikatës, dhe të datës së lëshimit të saj;

d) lëshimin e certifikatës përfundimtare për performancën e energjisë tek audituesi dhe pronari i ndërtesës, vetëm kur janë plotësuar kushtet e certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave, të përcaktuara në ndarjen I, të këtij kreu.

2. Nëse Certifikata e Performancës së Energjisë, pas vlerësimit të hedhjes së vlerave hyrëse nga agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë, refuzohet, audituesi kryen veprime korrigjuese ose kërkon tërheqjen e kërkesës për regjistrimin e Certifikatës për Performancën e Energjisë.

3. Regjistrimi përfundimtar i Certifikatës për Performancën e Energjisë, të lëshuar nga audituesi,

bëhet nga agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë, brenda 5 (pesë) ditëve pune, duke marrë vulën e firmën e agjencisë. Procesi i regjistrimit nuk parashikon verifikimin dhe kontrollin e CPE-së.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia për Eficiencën e Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**SHTOJCA 1**
**Modeli, përmasat dhe përmbajtja e CPE-së**



**Certifikata e Performancës së Energjisë**

Adresa: Blv. Bajram Curri,
Rr: "Viktor Eftimiu",
Ndërtesa Nr. 1, Kati V,
1022, Tirana,
Albania

**Kodi i Certifkatës:**
1234-1234-1234-1234

Kjo certifikatë është gjeneruar nëpërmjet programit kompjuterik (Ref. nr.) dhe aprovuar nga Agjencia përgjegjëse për Efiçencën e Energjisë. Ajo përcakton klasin e performancës së energjisë së ndërtesës dhe shoqërohet nga raporti me të njëjtin kod. Për informacione të mëtejshme viziton faqen zyrtare të Agjencisë përgjegjëse për Efiçencën e Energjisë www.eficenca.gov.al.

**Klasi i performancës energjetike**

Kjo tregon se sa me efikasitet është përdorur energjia në ndërtesë. Numrat nuk paraqesin njësi reale të energjisë së konsumuar; ato përfaqësojnë efiçencën e energjisë të krahasuar me një ndërtesë referente.

Ndërtesë Efiçente
A 0-25
B 26-50
C 51-75
D 76-100
E 101-125
F 126-150
G Mbi 150
Ndërtesë jo efiçente

50 janë kërkesat minimale

108

**Sistemet alternative të energjisë**

| | |
|---|---|
| Konfirmo nëse është konsideruar mundësia e përdorimit të sistemeve alternative me efiçencë të lartë energjetike | Po |
| Sistemet e përdorur në projektin e propozuar: | |
| • Sistem i decentralizuar që shfrytëzon BRE | |
| • Sistem koogjenerues | |
| • Sistem me pompa nxehtësie | |
| • Sistem i ngrohjes /ftohjes së përqëndruar | |

**Informacion teknik**

Kjo tregon informacione teknike se si përdoret energjia në këtë ndërtesë. Të dhënat e konsumit janë të bazuara në lexime aktuale.

| | |
|---|---|
| Bartësi energjetik primar: | Naftë |
| Konsumi i energjisë primare: | 2000 |
| Sipërfaqja e dobishme e ndërtesës (m²): | 2927 |
| Vlerësimi energjetik: | 92 |

| | Ngrohje | Ftohje |
|---|---|---|
| Energjia vjetore e përdorur (kWh/m²/vit) | 126 | 129 |
| Energjia nga Burimet e Rinovueshme | 0% | 20% |

**Informacion administrativ**

Të dhënat e paraqitura në këtë Certifikatë të Performancës së Energjisë janë në përputhje me ligjin Nr. 116 dt. 10.11.2016 për Performancën e Energjisë në Ndërtesa.

| | |
|---|---|
| Programi kompjuterik: | REF. |
| Metodologjia e Llogaritjes: | REF. |
| Audituesi i Energjisë: | |
| Numri i Certifikatës: | ABC12345 |
| Subjekti: | Emri |
| Nipt: | A12345678B |
| Numri i Certifikatës: | ABC12345 |
| Data e Lëshimit: | 12 Maj 2007 |
| Data e Skadimit: | 12 May 2017 |

Rekomandimet për të përmirësuar Efiçencën Energjetike të Ndërtesës janë të përfshira në Raportin e Auditimit me Kod: 1234-1234-1234-1234 i cili mund të aksesohet në faqen e internetit eecert.eficenca.gov.al.

**VENDIM**
**Nr. 960, datë 2.12.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 527, DATË 27.9.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM DHE VENDOSJEN E SERVITUTIT TË PËRHERSHËM TË KALIMIT, PËR INTERES PUBLIK, MBI DISA PASURI TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA KORRIDORI I PUNËS (RRUGËT HYRËSE) DHE SISTEMI I GAZSJELLËSIT (MIKROTUNELI), PJESË E PROJEKTIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (PROJEKTI TAP) AG"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 7 e 8, pjesa e parë dhe e dytë, të shtojcës 1, të marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, "Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG", si dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 527, datë 27.9.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 3 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme prej 29 112 048.47 (njëzet e nëntë milionë e njëqind e dymbëdhjetë mijë e dyzet e tetë pikë dyzet e shtatë) lekësh, për sipërfaqet, si më poshtë vijon:

- 29 (njëzet e nëntë) $m^2$, që shpronësohet;
- 7 433 (shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e tre) $m^2$, që merret në përdorim të përkohshëm;
- 1 478 (një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) $m^2$, mbi të cilën vendoset servituti.

5. Vlera e përgjithshme prej 29 112 048.47 (njëzet e nëntë milionë e njëqind e dymbëdhjetë mijë e dyzet e tetë pikë dyzet e shtatë) lekësh dhe të gjitha shpenzimet e tjera procedurale përfshirë edhe ato shtesë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, të përballohen nga shoqëria TAP AG, si subjekt kërkues.".

b) Të dhënat për numrat rendorë 1, 5, 6, 9 dhe 11, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria TAP AG, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përkatësisht, Korçë, Devoll, Berat, Skrapar e Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

LISTA E PASURIVE TË CILAT PREKEN NGA KORRIDORI I PUNËS (RRUGËT HYRËSE) DHE SISTEMI I GAZSJELLËSIT (MIKROTUNELI), RRETHET: KORÇË , DEVOLL, BERAT DHE SKRAPAR

| Nr. në VKM nr. 527, datë 27.9.2017 | Pronari/përdoruesi | | | ZK | Nr. pas. | Lloji i pas. | Sip. $m^2$ Përdorim të përkohshëm 2 vjet | Çmi-mi/ $m^2$ | Vlera, lekë | Sip. $m^2$ Servitut | Çmim/ $m^2$ | Vlera, lek | Sip. $m^2$ shpronësim | Çmimi/$m^2$ | Vlera, lek | Vlera totale e kulturave | Objekte, vlera lekë | Vlera totale, lek | Indeksi i hartës | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Petrit | Reshat | Xhizdari | 2739 | 207 | Kullotë | | | | 341 | 101 | 34,325.74 | | | | 17,425.00 | | 51,750.74 | K-34-125-(135-B) | ZVRPP-ja konfirmon se pasuria ka kufizim. |
| | Muharre m | Reshat | Xhizdari | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Beqir | Reshat | Xhizdari | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Ferdinant | Reshat | Xhizdari | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Lavdije | Reshat | Xhizdari | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Drita | Reshat | Xhizdari | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Tomorr | Hajri | Shurdhi | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Leonora | Hajri | Muabelliu | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Albana | Hajri | Shurdhi | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 5 | Maria | Rushan | Sulka | 2739 | 130/5 | Arë | 92 | 69.8 | 6,417.00 | 69 | 140 | 9,625.50 | | | | | | 16,042.50 | K-34-125-(119-C) | ZVRP-ja konfirmon se pasuria ka kufizim |
| | Faik | | Sulka | | | | | | | | | | | | | 164,230.40 | | 164,230.40 | | Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat. |
| 6 | Maria | Rushan | Sulka | 2739 | 130/6 | Arë | 142 | 69.8 | 9,904.50 | 93 | 140 | 12,973.50 | | | | | | 22,878.00 | K-34-125-(119-C) | ZVRPP-ja konfirmon se pasuria ka kufizim. |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Feti | | Sulka | | | | | | | | | | | | | 87,380.52 | | 87,380.52 | | Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat. |
| **9** | Pellumb | Sheme | Sulka | 2739 | 130/4 | Arë | 355 | 69.8 | 24,761.25 | 274 | 140 | 38,223.00 | | | | | | 62,984.25 | K-34-125-(119-C) | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| **11** | Dajlan | Rahman | Seitaj | 1420 | 1/19 | Truall | 775 | 175 | 135,625.00 | 367 | 630 | 231,210.00 | | | | 9,300.00 | 16,208,116.6 4 | 16,584,251.64 | CO-H-2 | ZVRPP-ja konfirmon se mbi pasurinë është vendosur sekuestro konservative dhe kufizim. |
| | Ardian | Shaqir | Caka | | | | | | | | | | | | | | | | | |

**VENDIM**
**Nr. 961, datë 2.12.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 465, DATË 26.7.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË KONTROLLIT TË MJETEVE MOTORIKE E RIMORKIOVE TË TYRE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 7, e vendimit nr. 465, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Periudha e veprimit të Task-Forcës do të jetë deri më 31 dhjetor 2021.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 962 , datë 2.12.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 144, DATË 18.2.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT "LUSHNJË–BERAT (LOTI 1, 2, 3 DHE OBJEKTET)"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 144, datë 18.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë "arë", "truall", "ullishte (tokë bujqësore)", "objekte" dhe "drufrutorë", me vlerë të përgjithshme shpronësimi 95 728 711 (nëntëdhjetë e pesë milionë e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) lekë, nga të cilat:

a) për "arë", "truall", "ullishte (tokë bujqësore)", me sipërfaqe shpronësimi 189 744 m$^2$, në vlerën 67 912 764 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë;

b) për "objekte", në vlerën 27 280 947 (njëzet e shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë) lekë;

c) për "drufrutorë", në vlerën 535 000 (pesëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë tokë "arë", "truall", "ullishte (tokë bujqësore)", "objekte" dhe "drufrutorë", prej 95 728 711 (nëntëdhjetë e pesë milionë e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar, zëri "Shpronë-simet".".

b) Të dhënat për pasurinë nr. 22/9, zona kadastrale 1098, në pronësi të z. Pëllumb Çela, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat në tabelën që bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera e shpenzimeve procedurale shtesë, sipas këtij vendimi, prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

LISTA EMËRORE E PRONARIT TË PASURISË, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 144, DATË 18.2.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT "LUSHNJË–BERAT (LOTI 1, 2, 3 DHE OBJEKTET)"

| Nr. rendor në VKM-në 144/2015 | Emri i pronarit | ZK | Nr. i pas. | Lloji i pasurisë | Sip. totale ($m^2$) | Sip. e shpronësuar ($m^2$) | Çmimi (lek/$m^2$) | Vlera për "tokën arë" | Vlera e kulturave bujqësore | Vlera totale (lek) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 347 | Pëllumb Çela | 1098 | 22/9 | arë | 5,642 | 666 | 502 | 334,332 | 535,000 | **869,332** | Konfirmim, AREB Lushnjë, me shkresë nr. 73/1, datë 5.3.2019 |
| **VLERA TOTALE (LEK)** | | | | | | | | | | **869,332** | |

## VENDIM
## Nr. 969, datë 2.12.2020

## PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RINISË, SI DHE TË MËNYRËS SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË TIJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 75/2019, "Për rininë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kritereve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë (në vijim KKR), si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij.

2. KKR-ja përbëhet nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët, të paktën 5 (pesë) janë femra. Anëtarët e KKR-së janë, si më poshtë vijon:

a) ministri përgjegjës për rininë, kryetar;

b) titullari i Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR);

c) 2 (dy) përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;

ç) 8 (tetë) përfaqësues nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë;

d) 4 (katër) përfaqësues anëtarë të këshillave studentorë.

3. Mandati i anëtarëve të KKR-së është dyvjeçar, me të drejtë riemërimi.

4. Anëtari i KKR-së mund të japë dorëheqjen në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim kryetarin. Anëtari i dorëhequr është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet e lëna deri në miratimin e urdhrit të ndryshimit.

5. Anëtarët e KKR-së duhet të deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Anëtarët e KKR-së kryejnë detyrën e tyre bazuar në parimin e mosdiskriminimit, të meritës, transparencës e gjithëpërfshirjes.

7. Kandidati për anëtar i KKR-së, përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kritere:

a) të ketë dhënë kontribut në fushën e rinisë të paktën për 2 (dy) vitet e fundit, nëpërmjet projekteve me fokus rininë apo të zhvillimit të nismave ose të aktiviteteve për promovimin e të rinjve;

b) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

8. Kandidati për anëtar i KKR-së, jo përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kritere:

a) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) të ketë përvojë pune në fushën e zhvillimit apo të zbatimit të aktiviteteve rinore, apo të ketë qenë pjesë e nismave ose aktiviteteve për promovimin e të rinjve;

c) të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe të dispozitave ligjore në fuqi.

9. Kandidati, për t'u emëruar anëtar i KKR-së, duhet të paraqesë, përkatësisht, dokumentacionin si vijon:

a) kandidati, përfaqësues i organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë:

i. kërkesën;

ii. jetëshkrimin;

iii. fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin;

iv. vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;

v. vetëdeklarimin e konfliktit të interesit.

b) kandidati, jo përfaqësues i organizatave rinore:
i. kërkesën;
ii. jetëshkrimin;
iii. fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin;
iv. vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
v. letër motivimi;
vi. vetëdeklarimin e konfliktit të interesit.

10. Thirrja për kandidatët e përmendur në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 2, të këtij vendimi, publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare për Rininë (AKR) për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh. Votimi përzgjedhës kryhet në formë elektronike në faqen zyrtare të AKR-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e fillimit të procesit të votimit.

11. KKR-ja mblidhet jo më pak se 2 (dy) herë në vit. Mbledhjet thirren e drejtohen nga kryetari. Sekretariati teknik njofton anëtarët e KKR-së, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen.

12. Mbledhja e KKR-së zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të tij.

13. KKR-ja mbështetet nga sekretariati teknik, i cili përbëhet nga tre anëtarë. Caktimi i anëtarëve të sekretariatit teknik e procedura e thirrjes së mbledhjes apo elemente të tjera për funksionimin e KKR-së përcaktohen në rregulloren e brendshme, e cila miratohet nga ministri përgjegjës për rininë.

14. Në çdo mbledhje të KKR-së mbahet procesverbali që pasqyron të gjitha diskutimet gjatë mbledhjes. Procesverbali nënshkruhet nga çdo pjesëmarrës në mbledhjen përkatëse të KKR-së.

15. Mandati i anëtarit të KKR-së mbaron kur:
a) përfundon afati dyvjeçar nga data e emërimit;
b) humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate apo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
c) jep dorëheqjen.

16. Anëtari i Këshillit Kombëtar të Rinisë lirohet nga detyra, para mandatit, nga ministri përgjegjës për rininë, në rastet kur:
a) nuk paraqitet, pa shkaqe të justifikuara, në të paktën 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme të KKR-së;
b) paraqiten shkaqe objektive, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;
c) nuk përmbush detyrimet si anëtar i KKR-së;
ç) veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KKR-së.

17. Anëtari i KKR-së, të cilit i është ndërprerë mandati apo është liruar nga detyra, zëvendësohet nga ministri përgjegjës për rininë me një kandidat që përmbush kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

18. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit zëvendësues është sa pjesa e mbetur e mandatit të anëtarit të larguar.

19. Ngarkohet Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore t'i propozojë ministrit përgjegjës për rininë anëtarët e tyre përfaqësues në Këshillin Kombëtar të Rinisë.

20. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 974, datë 2.12.2020**

## PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. KRISTJAN ÇARERI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 42, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Kristjan Çareri, në masën 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 976, datë 2.12.2020**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË TEATRIT KOMBËTAR EKSPERIMENTAL "KUJTIM SPAHIVOGLI"**

Në mbështetje pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Kiço Londo, drejtor i Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Altin Basha emërohet drejtor i Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 977, datë 2.12.2020**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E PËRGATITJES SË SHESHEVE TË NDËRTIMIT, NË BASHKITË KAVAJË DHE KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja "a", të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën prej 115 377 718 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh, për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit në bashkitë Kavajë dhe Krujë.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi prej 43 000 000 (dyzet e tre milionë) lekësh, për financimin e shembjeve të objekteve të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre.

b) Bashkisë Krujë i transferohet fondi prej 72 377 718 (shtatëdhjetë e dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh, për financimin e shembjeve të objekteve të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kavajë dhe Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 978, datë 2.12.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 84, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE PEZË, BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "iii" e "iv", dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Harta dhe koordinatat bashkëlidhur vendimit nr. 84, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, përkatësisht, me hartën dhe koordinatat bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**




| Pika | Koord_X | Koord_Y |
|---|---|---|
| 1 | 390954.83 | 4565672.45 |
| 2 | 390952.30 | 4565685.68 |
| 3 | 390953.21 | 4565691.19 |
| 4 | 390969.52 | 4565705.75 |
| 5 | 390982.43 | 4565726.96 |
| 6 | 390989.89 | 4565740.65 |
| 7 | 390998.62 | 4565738.43 |
| 8 | 391015.82 | 4565736.78 |
| 9 | 391058.16 | 4565719.91 |
| 10 | 391094.87 | 4565705.69 |
| 11 | 391107.43 | 4565702.38 |
| 12 | 391141.17 | 4565702.38 |
| 13 | 391172.92 | 4565704.03 |
| 14 | 391173.16 | 4565699.29 |
| 15 | 391171.86 | 4565693.44 |
| 16 | 391164.86 | 4565646.76 |
| 17 | 391134.63 | 4565629.44 |
| 18 | 391098.45 | 4565644.13 |
| 19 | 391127.89 | 4565643.31 |
| 20 | 391120.53 | 4565639.06 |
| 21 | 391109.01 | 4565638.10 |
| 22 | 391100.17 | 4565639.07 |
| 23 | 391090.44 | 4565638.79 |
| 24 | 391083.61 | 4565639.28 |
| 25 | 391057.52 | 4565640.64 |
| 26 | 391049.64 | 4565640.47 |
| 27 | 391027.07 | 4565642.81 |
| 28 | 391011.72 | 4565642.25 |
| 29 | 390994.28 | 4565644.38 |
| 30 | 390981.27 | 4565647.82 |
| 31 | 390962.81 | 4565662.57 |

| Pika | Koord_X | Koord_Y |
|---|---|---|
| 1 | 390954.83 | 4565672.45 |
| 2 | 390952.30 | 4565685.68 |
| 3 | 390953.21 | 4565691.19 |
| 4 | 390969.52 | 4565705.75 |
| 5 | 390982.43 | 4565726.96 |
| 6 | 390989.89 | 4565740.65 |
| 7 | 390998.62 | 4565738.43 |
| 8 | 391015.82 | 4565736.78 |
| 9 | 391058.16 | 4565719.91 |
| 10 | 391094.87 | 4565705.69 |
| 11 | 391107.43 | 4565702.38 |
| 12 | 391141.17 | 4565702.38 |
| 13 | 391172.92 | 4565704.03 |
| 14 | 391173.16 | 4565699.29 |
| 15 | 391171.86 | 4565693.44 |
| 16 | 391164.86 | 4565646.76 |
| 17 | 391134.63 | 4565629.44 |
| 18 | 391098.45 | 4565644.13 |
| 19 | 391127.89 | 4565643.31 |
| 20 | 391120.53 | 4565639.06 |
| 21 | 391109.01 | 4565638.10 |
| 22 | 391100.17 | 4565639.07 |
| 23 | 391090.44 | 4565638.79 |
| 24 | 391083.61 | 4565639.28 |
| 25 | 391057.52 | 4565640.64 |
| 26 | 391049.64 | 4565640.47 |
| 27 | 391027.07 | 4565642.81 |
| 28 | 391011.72 | 4565642.25 |
| 29 | 390994.28 | 4565644.38 |
| 30 | 390981.27 | 4565647.82 |
| 31 | 390962.81 | 4565662.57 |

**VENDIM**
**Nr. 979, datë 2.12.2020**

## PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E HARTIMIT TË PROJEKTIT TË NDËRHYRJEVE REHABILITUESE/ PËRSHTATËSE TË NEVOJSHME PËR KTHIMIN E STRUKTURËS SË OBJEKTEVE, QË JANË KLASIFIKUAR SI OBJEKTE ME DËMTIME TË MËDHA STRUKTURORE OSE DËMTIME SHUMË TË RËNDA JOSTRUKTURORE, NË BASHKINË KAMZË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 19 323 960 (nëntëmbëdhjetë milionë e treqind e njëzet e tre mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, për ndërhyrjet strukturale të nevojshme, për njësitë e banimit në ndërtesa (pallat), bazuar në rekomandimet e aktekspertizave të thelluara të bëra nga Instituti i Ndërtimit, në Bashkinë Kamzë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 980, datë 2.12.2020**

## PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIMIT, ZBATIMIT TË PUNIMEVE, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË QENDRËS SË SHËRBIMEVE DHE ADMINISTRIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me

propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara si njësi zbatuese për projektimin, zbatimin e punimeve, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit (QSHAMT).

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, nga njësia zbatuese, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në masën 275 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë milionë) lekë, për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit.

3. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, të jetë në masën 55 000 000 (pesëdhjetë e pesë milionë) lekë, dhe të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit.

4. Fondi i përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, i shtohet Ministrisë së Brendshme, në programin "Planifikim menaxhim", për Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara.

5. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin "Fondi për rindërtim", të buxhetit të shtetit.

6. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Blerjeve të Përqendruara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

## VENDIM
## Nr. 981, datë 25.11.2020

## PËR TRANSFERIM FONDI, NGA BUXHETI I VITIT 2020, MIRATUAR PËR MINISTRINË E KULTURËS, PËR QENDRËN KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 4, të ligjit nr. 8096, datë 21.3.1996, "Për kinematografinë", të ndryshuar; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, t'i transferohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, në formën e grantit për Akademinë e Filmit dhe Multimedias "Marubi", për mbështetjen e veprimtarive krijuese.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë së Kulturës, artikulli 604.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## KËRKESË
## Nr. 4245/10, datë 16.11.2020

## PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Kulturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti "Muzeu Hebraik Shqiptar në Vlorë".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në vendim nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në DRTK Vlorë si dhe në Ministrinë e Kulturës.

Ernest Sefedin Tozaj: 3,241,873.3 (tre milionë e dyqind e dyzet e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre pikë tre lekë) dhe për shtetasin Gjergji Korabi, në vlerën 3,495,489.3 (tre milionë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë pikë tre lekë).

Vlera totale paraprake të shpronësimit: 6,737,362.6 (gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy pikë gjashtë lekë).

ZËVENDËSMINISTËR I KULTURËS
**Meri Kumbe**

LISTA PARAPRAKE ME EMRAT E PRONAREVE, PER PASURITE E PALUAJTSHME QE PREKEN NGA PROJEKTI "MUZEU HEBRAIK SHQIPTAR NE VLORE" (projekti propozim paraprak, ende i pamiratuar)

Zona Kadastrale 8601 (pasurite e paluajtshme dhe cmimi mesatar i shitblerjeve per tre muajt e fundit, sipas konfirmimit te derguar nga Agjencia Shteterore e Kadastres me shkresen nr. 7730/1 prot., date 29.09.2020 dhe shkresen nr. 8713/2 prot., date 11.11.2020)

| Nr | Zona kadastrale | Nr. Pasurise | Adresa | Pronari | Siperfaqe Trualli | Siperfaqe ndertimi | Çmimi i Truallit Leke/m2 | Çmimi i Ndertimi Leke/m2 | Vlera e Truallit Leke | Vlera e Ndertimit Leke | Vlera truall dhe ndertese | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 8601 | 20/2+1-1 | Vlore | Ernest Sefedin Tozaj | - | 58.8 | - | 55,133.9 | - | 3,241,873.3 | - | Konfirmuar nga Agjencia Shteterore e Kadastres. |
| 2 | 8601 | 20/2 | Vlore | Mariban Korabi | - | | - | 55,133.9 | - | 0.0 | - | E pakonfirmuar siperfaqja (referuar shkreses se A.Sh.K, nr. 7730/1 prot., date 29.09.2020. |
| 3 | 8601 | 20/2 | Vlore | Gjergji Korabi | - | 63.4 | - | 55,133.9 | - | 3,495,489.3 | - | E pakonfirmuar (referuar shkreses se A.Sh.K, nr. 7730/1 prot., date 29.09.2020. |
| | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | |

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 211
Datë: 2020/12/04 13:58:44
9caa1fb5-e6ce-4d6f-9bc5-377c1335261e

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë